

ESKE

Ermittlung **schulsprachlicher Kompetenzen** in der **Erstsprache**

ALBANISCH

Aufgabenset 7 bis 9 Jahre Schulerfahrung

© Pädagogische Hochschule FHNW 2018

Professur Deutschdidaktik und Mehrsprachigkeit im Kindesalter

Mathilde Gyger & Ursula Ritzau

Detyrat

1. Lexo tekstin dhe përgjigju në pyetjet.

Çipsat nga patatet (patatina)

Çipsat nga patatet (patatinat) janë feta të holla të patatës të fërguara dhe janë njëri nga zbulimet më të diskutuara të shekullit të 19-të. Ka shumë rrëfime për atë se kush i ka zbuluar dhe hedhur në shitje. Është thuhajse e pamundur të konstatohet se sa të vërteta përmbajnë këto histori zbulimi. Tregimi më i përhapur është ai i kuzhinierit George Crum. Ai me 24 gusht të vitit 1853 për t'i përmbushur dëshirën një klientit të pakënaqur i ka prerë patatet në feta (pjesë) të holla, i ka fërguar dhe i ka kriposur, dhe rezultati: Një klient i pakënaqur u bë një klient shumë i kënaqur. Ky rrëfim mund të ishte i vërtet, por ne e dimë që edhe kuzhinierë të tjerë në fillim të shekullit 19-të kishin të njëjtat ide. Produkte të njehta përmendën edhe në libra të tjerë të kuzhinës në Amerikë dhe produkte të ngjajshme janë zhvilluar edhe në Britaninë e Madhe. Për herë të parë në vitet 1890 çipsat nga patatet (patatinat) janë shitur në shitoret ushqimore; por ekspansioni i vërtet i këtij produkti dhe shitja e tij ka arritur me zbulimin e fërgueses nga fundi i viteve 1920. Me këte, me ndryshimin e mënyrës së paketimit është arritur që në deceniet në vazhdim, çipsat të mund të transportoheshin edhe në relacione të gjata në SHBA. Në Europë një shitje e hovshme arrin tek në fillim të viteve të 50-ta.



Për çka e shkroi autori këtë tekst?

- Për të informuar lexuesit mbi historinë e çipsave të patates (patatina).
- Që lexuesit të i argëtoj me një tregim qesharak.
- Që të ju tregoj lexuesve se si prodhohen çipsat nga patatet (patatinat).

A e dimë ne kush i ka zbuluar çipsat nga patatet (patatinat)?

- Po, ishte George Crum.
- Jo, mund të kenë qenë shumë persona.
- Jo, por ne e dimë se kur u zbuluan ato.

Ne dimë përafërsisht kur u zbuluan çipsat nga patatet (patatinat).

Saktë
Pasaktë

Çipsat nga patatet (patatinat) janë shitur së pari në Europë.

Saktë
Pasaktë

Ekzistojnë arsye të ndryshme për të cilat njerëzit në shekullin e 20-të kanë ngrënë çipsat nga patatet (patatinat).

Saktë
Pasaktë

2. Më poshtë gjindet një tekst i shkurtër dhe katër diagrame klimatike për katër qytete të ndryshme. Lexo tekstin, shiko diagramet dhe spjego shkurt me gojë për çfarë bëhet fjalë.

Temperatura dhe të reshurat

Në disa vende të botës, në verë bie shumë shi, ndërsa në rajone të tjera thujse nuk bie fare shi. Në disa regjione temperatura qëndron thujse e pandryshuar gjatë tërë vitit. Në rajone të tjera ka dallime shumë të mëdha në mes të verës dhe dimrit, sikurse edhe në Zvicër. Katër qytetet të shënuara në diagrame gjenden në Kontinente të ndryshme dhe kanë klimë të ndryshme. Hanoi gjendet në Vietnam, Tunis është kryeqyteti i Tunizisë në detin Mesdhe, Dublini gjendet në Irlandë ndërsa Jakutsk gjendet në mes të Rusisë.







Figura 1. Diagramet klimatike janë të përbëra nga një diagram i të reshurave dhe një diagram i temperatures. Të reshurat lexohen majtas në milimetra, ndërsa temperatura lexohet djathtas në Grad Celsius. Diagramet tregojnë të reshurat dhe temperaturat në mesatare nga Janari deri në Dhjetor.

3. Pyetjet për tekstin „Temperatura dhe të reshurat“ (detyra 2)

A. Kryqëzo në bazë të tekstit dhe diagramit në detyrën numër 2 qytetin e saktë në skemë.

	Hanoi	Tunis	Dublin	Jakutsk
Gjatë vitit ndryshon temperatura mesatare në mes të 5 dhe 15 Grad Celsius.				
Qyteti ka në verë më së paku reshje dhe nga maji deri në tetor ka 20 apo më tepër Grad Celsius.				
Të reshurat prej tetorit deri në prill mund të bien edhe si dëborë.				

B. Shiko diagramin e qytetit Jakutsk nga detyra numër 2 dhe kryqëzo këtu shprehjen e saktë.

Moti në nëntor në Jakutsk i përgjigjet...

Afërsisht 0°C dhe afërsisht 20 mm reshje.	<input type="checkbox"/>
Afërsisht -10°C dhe afërsisht 50 mm reshje.	<input type="checkbox"/>
Pak nën 10°C dhe afërsisht 60 mm reshje.	<input type="checkbox"/>
Afërsisht -30°C dhe gati 10 mm reshje.	<input type="checkbox"/>

C. Në cilat qytete ndryshojnë sasia e të reshurave dhe temperaturat më së shumti, në bazë të diagrameve në detyrën numër 2? Rrumbullakëso qytetet e sakta.

Sasia e të reshurave më së shumti ndryshon në:

Hanoi	Tunis
Dublin	Jakutsk

Temperaturat më së shumti ndryshojnë në:

Hanoi	Tunis
Dublin	Jakutsk

4. Lexo këto dy letra të lexuesve dhe spjego shkurt me gojë për çfarë bëhet fjalë.

Letra e lexuesit 1

Jepni fëmijëve ujë në vend të qumështit

Qumështi i lopëve nëpër shkollë nuk është natyral. Njeriu është e vetmja qenie (specie) në botë, që e pinë qumështin e një qenie tjetër.

Një studim shkencor gjithëpërfshirës është botuar këtë të mërkurë në gazetë. Me këtë është dokumentuar që opinioni më i përhapur mbi qumështin e lopës është i tejkualuar. Studimi e lidhë konsumimin e qumështit me një jetëgjatësi më të shkurtër dhe me një rrezik më të madh për thyerje të eshtrave. Qumështi i lopës nuk është as natyral as i mirë për shëndetin e popullit dhe ambientin. Për këtë arsye është koha që fëmijët tanë të mësojnë zakone të reja të shëndetshme dhe të dobishme për ambientin: Jepni nxënësve ujë për të shuar etjen.

Herbert Müller

Drejtori i organizatës „Ushqimi vegjetarian“

Letra e lexuesit 2: Përgjigje Herbert Müller-it

Qumështi i takon tryezës së drekës

Herbert Müller nuk dëshiron që fëmijët në shkollë të pinë qumësht. Organizata ime dhe Kombet e Bashkuara përfaqësojnë qëndrimin e kundërt: Të gjithë fëmijët duhet që në shkollë të marrin qumësht falas.

Qumështi përmban 18 nga 22 materjet ushqyese të cilat na nevoiten në përditëshmëri dhe siguron një ushqim të shëndoshë për nxënësit. Studime të reja tregojnë që nxënësit nuk marrin materje ushqyese të mjaftueshme nëse nuk pinë qumësht gjatë drekës (racionit ushqimor) në shkollë.

Ekspertja e ushqimit Ulla Rosander nga universiteti Kristianstad në Suedi ka bërë një studim në tri shkollë suedeze. Në të tri shkollat është servuar e njejta meny në drekë, por vetëm në një nga shkollat fëmijët kanë marrë edhe qumësht.

Rezultatet tregojnë, që para së gjithash fëmijët që marrin racione të vogla apo ose kanë pak kohë, kanë nevojë për qumësht në mënyrë që të furnizohen me kalcium, vitamin B12 dhe magnezium. Për këtë arsye është shumë i nevojshëm qumështi në shkollë.

Susanne Pfister

Reprezantuese e organizatës „Për Bujkun“

5. Kryqëzo në bazë të dy letrave të lexuesve në detyrën numër 4 përgjegjjet (thënjet) e sakta.

- a) Përse zonja Pfister e sheh të rëndësishme që nxënësit të pinë qumësht?
- Fëmijët hanë më shumë, nëse pinë qumësht.
 - Konsumimi i qumështit e zgjatë jetën.
 - Qumështi përmban shumë materje ushqyese.
- b) Përse zotëri Müller mendon, që për fëmijët është më mirë të pinë ujë se sa qumësht?
- Uji kushton më lirë se qumështi.
 - Uji është më i mirë për ambientin.
 - Uji e shuan etjen më mirë.
- c) Çfarë tregojnë hulumtimet sipas letrave të lexuesve?
- Konsumimi i qumështit ka pasoja pozitive dhe negative.
 - Shujtat në shkollë përmbajnë mjaft materje ushqyese edhe pa qumësht.
 - Konsumimi i qumështit i forcon eshtrat.
- d) Përse zonja Pfister shkruan letrën e lexuesve?
- Ajo dëshiron t'a sqaroj, përse ajo është e mendimit se zotëri Müller nuk ka të drejtë.
 - Ajo dëshiron të sqaroj se uji është i dobishëm për ambientin.
 - Ajo nuk dëshiron që nxënësit të hanë pak ushqim.
- e) Zotëri Müller argumenton, që jeta e jonë është më e shkurtër nëse ne pimë shumë qumësht. E saktë
E pasaktë
- f) Zotëri Müller dhe zonja Pfister, në dy letrat e lexuesve, nxjerrin në pah të njejtat rezultate nga hulumtimi. E saktë
E pasaktë
- g) Shkenctarët janë të një mendimit në lidhje me efektet e konsumimit të qumështit. E saktë
E pasaktë

6. Cila nga dy letrat e lexuesve në detyrën numër 4 mendon se është më bindëse? Spjego me gojë përse.

7. Çka nënkuptojnë këto terme? Kryqëzo kuptimin e saktë.

a) Etika është...

- çka ne bëjmë dhe nuk bëjmë dhe si reagojnë njerëzit e tjerë..
- bindjet se çka është e drejtë dhe jo e drejtë.
- një periudhë historike.

b) Çka përshkruan gramatika?

- si shqiptohen fjalët.
- sa është i gjatë një tekst.
- si janë formuar fjalët dhe fjalitë.

c) Cili është personazhi kryesor në një tregim?

- personi i cili e ka shkruar tekstin.
- personazhi më i rëndësishëm i tregimit.
- personi i parë i cili është përmendur në tregim.

d) Çka do të thotë konsensus?

- marrëveshje (dakordim)
- shumicë.
- leje.

8. Shiqo skemën dhe përgjigju në pyetjet.

Nico është 15-vjeçar dhe është në klasën e 9-të. Të mërkurën pasdite ai punon si punëtor ndihmës në një restorant. Në kohën e lirë ai luan me dëshirë futboll. Këtu është plani i tij javor.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
7.45-9.15	GjH2	GjH1	MAT	GjH2	GjH1
9.15-9.45	<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>
9.45-11.15	MAT	GJEO	ShNAT	ShNAT	HIS
11.15-12.00	MAT	GJEO	GjL	GjL	GjL
12.00-13.30	<i>pushimi i drekës</i>	<i>pushimi i drekës</i>	<i>pushimi i drekës</i>	<i>pushimi i drekës</i>	<i>pushimi i drekës</i>
13.30-15.00	GjH1	HIS	GjH1	GjL	EdF
15.00-15.30	<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>		<i>pushimi</i>	<i>pushimi</i>
15.30-17.00	GjL	EdF		MAT	MUZ
17.00-18.00			punë		
18.00-19.00			punë		
19.00-20.00	futboll		punë	futboll	
20.00-21.00	futboll		punë	futboll	
21.00-22.00			punë		

Legjenda

GjH1	Gjuhë e huaj 1 (anglisht)
GjH2	Gjuhë e huaj 2 (frëngjisht)
GJEO	Gjeografi
HIS	Histori
MAT	Matematikë
MUZ	Muzikë
ShNAT	Shkenca natyrore
GjL	Gjuhë dhe letërsi
EdF	Edukatë fizike

Pyetjet

1. Sa orë të matematikes i ka Nico çdo jave?

Përgjigje: _____

2. Cilën lëndë e ka vetëm një herë në javë Nico?

Përgjigje: _____

3. Cilat lëndë Nico nuk i ka para pushimit të drekës?

Përgjigje: _____

